

BACHELOR NË “IMAZHERI”

OBJEKTIVAT E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Programi i studimit Bachelor në “Imazheri” synon të përgatisë studentë që të demonstrojnë aftësitë e duhura për t’i shërbyer komunitetit si profesionistë të imazheve duke treguar kujdesin e duhur ndaj pacientit, përmes integritetit të vlerave profesionale, njohurive didaktike dhe aftësive klinike.

REZULTATET E TË NXËNIT

Në përfundim të këtij programi, studenti do të jetë i aftë të:

- Demonstrojë kompetencë klinike:
 - Tregojë kujdesin e duhur ndaj pacientit.
 - Sigurojë imazhe diagnostikuese sipas protokollit.
 - Zbatojë masat e duhura të sigurisë për mbrojtjen nga rrezatimi duke respektuar faktorët e ekspozimit.
- Shfaqë sjellje profesionale dhe etike:
 - Përshtatet me efikasitet për të punuar si pjesë e një ekipi.
 - Tregojë sjellje profesionale dhe etike.
 - Kuptojë rëndësinë e zhvillimit të vazhdueshëm profesional.
- Përdorë të menduarit kritik dhe aftësi të zgjidhjes së problemeve:
 - Modifikojë parametrat normalë të imazhit duke u përshtatur ndaj kufizimeve të pacientit.
 - Vlerësojë cilësinë e imazhit duke përdorur veprime korrigjuese për të siguruar imazhe optimale.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Studentët që mbarojnë programin e studimit “Bachelor” në Imazheri mund të punojnë si teknikë imazherie në:

- Spitalet dhe poliklinikat publike dhe private;
- Qendra Diagnostike të kujdesit parësor dhe urgjencës;
- Klinika të Kujdesit Paliativ publik dhe privat;
- Agjenci shëndetësore që kontribuojnë në përdorimin e pajisjeve diagnostikuese apo terapeutike mjekësore duke respektuar standardet e sigurisë të ekspozimit ndaj rrezatimit;
- Qendra stomatologjike ose kabinete private radiologjike;
- Organizata të specializuara ndërkombëtare të diagnostikimit imazherik.

Mbajtësi i diplomës gëzon të drejtën të licensohet për ushtrimin e profesionit të rregulluar të teknikut të imazherisë, referuar kuadrit ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.



BACHELOR "IMAZHERI" 180 ECTS

Nr.	Viti	Sem	Emri i lëndës	ECTS
-----	------	-----	---------------	------

A - LËNDË BAZË/ 15-20%/31 ECTS

1	I	1	Biologji Humane	5
2	II	1	Hyrje në Psikologji	6
3	I	1	Shkrim Akademik + Metodot e kërkimit	8
4	I	2	Statistikë	6
5	I	1	Kimi e përgjithshme dhe inorganike	6
				31

B - LËNDË KARAKTERIZUESE TE PROGRAMIT 50-55%/92 ECTS

1	I	1	Anatomi 1	5
2	I	2	Anatomi 2	5
3	I	1	Biofizikë	4
4	II	2	Biokimi mjekësore	5
5	I	2	Histologji dhe Anatomi patologjike e përgjithshme	6
6	II	1	Fiziologji	6
7	I	2	Bazat e radiologjisë diagnostike	6
8	II	1	Teknikat ekzaminuese në imazherinë diagnostike	6
9	II	2	Principet e mbrojtjes nga rrezatimi	5
10	II	2	Tomografia e kompjuterizuar - CT	5
11	III	1	Rezonanca magnetike - MRI	6
12	III	1	Hyrje në mjekësinë nukleare: teknikat dhe aparaturat	6
13	II	1-2	Praktikë 1-2	8
14	III	1-2	Praktikë 3-4	8
15	III	2	Radioterapi interne dhe eksterne	6
16	III	2	Radiologji urgjence	5
				92

C - LËNDË NDËRDISIPLINORE / INTEGRUESE /12-15%/23 ECTS

1	II	1	Principet e sëmundjeve të brendshme	6
2	III	1	Deontologji, etikë dhe legjislacion mjekësor	6
3	II	2	Shëndetit publik	6
4	II	2	Farmakologji	5
5	II	2	Mjekësi laboratorike dhe Mikrobiologji	6
6	II/III	1-2	Honors Course	6
				23

D - LËNDË PLOTËSUESE 10-15%/27 ECTS

1	I	1	Terminologji mjekësore	4
2	I	2	Anglisht	5
3	II	1	Bazat e informatikës	4
4	III	1	Praktikë Klinike I	7
5	III	2	Praktikë Klinike II	7
				27

E - DETYRIME PËRMBYLLËSE/3-5% /7 ECTS

1	III	2	Punimi i diplomës/ Provim i përgjithshëm përfundimtar	7
---	-----	---	---	---